


BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA
TË KOSOVËS

BSPK

Nr. 124

Data. 11.07 26

PRISHTINË



STATUTI

I BASHKIMIT TË SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS (BSPK)

Prishtinë, 2026

Dispozitat e përgjithshme

1. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (në tekstin e mëtejme BSPK), është konfederatë sindikale e federatave/sindikatave, vullnetarisht të anëtarësuar dhe të organizuara sipas veprimtarive ekonomike dhe profesionale bazuar në Ligjin nr. 04/L-011 për organizimin sindikal në Kosovë;
2. BSPK përfaqëson interesat e përbashkëta ekonomike, sociale dhe kulturore të të punësuarve, të anëtarësuar në Federatë/Sindikata;
3. BSPK është e pavarur nga qeveria, nga organizatat e punëdhënësve dhe nga partitë politike;
4. BSPK gëzon të drejtën e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare sindikale;
5. BSPK promovon parimet e së drejtës sociale e demokratike, respektimin e standardeve ndërkombëtare duke insistuar në ratifikimin dhe implementimin e Konventave të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), të Rezolutave Sociale të Evropës, si dhe në respektimin e të drejtave njerëzore dhe sindikale;
6. BSPK operon brenda Republikës së Kosovës, në frymën e kushtetutës, të konventave ndërkombëtare, të ligjeve, të marrëveshjeve kolektive, të rregulloreve e akteve të tjera normative të njohura, si dhe të programit e të statutit të BSPK-së;
7. BSPK në kushtet e reformave ekonomike, pra të një ekonomie të tregut, angazhohet për krijimin e një shoqërie pa korrupsion, pa privilegje dhe diskriminime, pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare, racore, gjinore, sociale, bindjet fetare, politike, etj.
8. BSPK angazhohet për zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik dhe shoqëror të Kosovës, duke zhvilluar dialogun social me partnerët socialë, qeverinë, punëdhënësit, sindikatat kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me organizmat e institucionet e tjera legale dhe legjitime.

Neni 1

Emërtimi

1. Emërtimi i plotë i Konfederatës është: “Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës”;
2. Shkurtesa e saj është: “BSPK”;
3. Në komunikimin ndërkombëtar BSPK shfrytëzon emërtimin në gjuhën angleze “The Union of Independent Trade Unions of Kosovo”;
4. Selia e BSPK-së është në adresën: Rr. “Bill Klinton”, nr. 60, 10000 Prishtinë, Kosovë.
5. BSPK ka statusin e personit juridik, me status kushtetues ligjor të posaçëm (organizatë *Sui-generis*).

Neni 2

Emblema, flamuri, vula e rrumbullakët dhe vula katrore

1. BSPK ka emblemen e vet, në formë katërkëndëshi, me kombinim të ngjyrave: të verdhës, të kuqes dhe të zezës. Përmbi emblemen qëndron mbishkrimi me shkurtesën “BSPK”;
2. BSPK ka flamurin e vet, i cili përmban emblemen me prapavijë të bardhë;
3. BSPK ka vulën e rrumbullakët, me emërtimin e plotë dhe selinë;
4. Teksti në vulën e BSPK-së shkruhet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, si: Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, The Union of Independent Trade Unions of Kosovo, (në mes) BSPK, Prishtinë;
5. BSPK ka vulën në formë të katërkëndëshit me emërtimin e plotë të BSPK-së dhe selinë e saj e cila shërben për evidencimin e shkresave zyrtare;
6. Federatat Sindikale, anëtare të BSPK-së, në shkresat zyrtare së bashku me emblemen e tyre mund ta përdorin edhe emblemen e BSPK-së.

Neni 3

Xhirollogaria

1. BSPK ka xhirollogaritë e veta në bankat komerciale të licencuara të Republikës së Kosovës.

Neni 4

Qëllimet e BSPK-së

1. BSPK ushtron veprimtarinë e saj për një shoqëri në të cilën të gjithë të punësuarit dhe qytetarët do të gëzojnë të drejtën në punë, në realizimin dhe në mbrojtjen e interesave ekonomike, sociale, edukative dhe kulturore, e në veçanti:
 - a. Respektimin e të drejtave themelore të të punësuarve;
 - b. Zhvillimin e dialogut social në nivel vendi;
 - c. Hartimin, negocimin, nënshkrimin dhe implementimin e marrëveshjeve kolektive në nivel vendi;
 - d. Promovimin e politikave për krijimin e kushteve dinjitoze për punë, për të gjithë të punësuarit, anëtarë të federatave që funksionojnë në kuadër të BSPK-së;
 - e. Angazhimin për zhvillimin e sistemit të përgjithshëm të sigurimit social në të cilin do të kenë qasje të gjithë të punësuarit;
 - f. Angazhimin për eliminimin e çdo lloj diskriminimi nga marrëdhënia e punës;
 - g. Sigurimin dhe angazhimin për krijimin dhe zbatimin e një legjislacioni demokratik bashkëkohor që sanksionon dhe mbron të drejtat e punëtorëve duke bërë propozime konkrete pranë organeve ligjdhënëse;
 - h. Rregullimin e raporteve ndërsindikale, si dhe zgjidhjen e konflikteve eventuale me qëllim të forcimit të unitetit dhe fuqisë sindikale;
 - i. Bashkëpunimin reciprok me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe me organizatat e punëdhënësve në kuadër të partneritetit në nivel vendi;
 - j. Mbrojtjen e së drejtës për zgjedhje të lirë të profesionit, të vendit të punës, të ngritjes së nivelit arsimor dhe të kualifikimit profesional sipas vendit të punës;
 - k. Mbrojtjen e anëtarëve nga veprimet burokratike, arbitrare a nga largimet-përfjashtimet, nga padrejtësia në punë nga ana e punëdhënësit;
 - l. Presion për punësimin e punëtorëve të papunë, si dhe të atyre që për shkaqe ekonomike mbesin të papunë dhe kërkojnë zgjedhjen e statusit të tyre;
 - m. Solidarizimi me sindikatat vendore dhe ndërkombëtare etj.

Neni 5

Përgjegjësitë e BSPK-së

BSPK është përgjegjëse për:

1. Përfaqësimin e interesave të përbashkëta të anëtarësisë së federatave anëtare të saj;
2. Udhëheqjen e dialogut social në nivel vendi;
3. Promovimin e sindikalizmit si formë e organizimit të lirë të të punësuarve, për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre;
4. Koordinimin e Federatave Sindikale lidhur me çështjet e përbashkëta;
5. Ofrimin e mbështetjes për Federatat Sindikale të saj;
6. Përfaqësimin e federatave/sindikatave në negociata dhe në diskutime me të gjitha organet dhe institucionet relevante të interesit;
7. Përfaqësimin në organizatat ndërkombëtare në të cilat BSPK është e anëtarësuar dhe ku mund t'i shprehë qëndrimet e veta, si dhe t'i mbrojë interesat e anëtarësisë së saj.

Neni 6

Statuti

1. Statuti është normativi më i lartë ligjor i brendshëm i BSPK-së;
2. Statuti i BSPK-së miratohet, ndryshohet dhe plotësohet nga Kongresi me shumicë votash të të gjithë delegatëve (50%+1);
3. Iniciativën për ndryshim a plotësim të statutit mund ta iniciojë Kryetari i BSPK-së, Këshilli Drejtues dhe Kryesia e BSPK-së, Komisioni Statutar ose të paktën një e treta e delegatëve të Kongresit;
4. Këshilli Drejtues cakton një afat kohor për propozimet, për ndryshimet në nenet e statutit;
5. Pavarësisht nga paragrafi i dytë i këtij neni, ndryshimet në statut, që nuk prekin organizimin e brendshëm të BSPK-së dhe kur gjykohet e nevojshme për funksionimin më të mirë të BSPK-së, mund t'i bëjë Këshilli Drejtues me një shumicë prej dy të tretave të të gjithë anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe me pëlqimin e Komisionit Statutar.

Neni 7

Format e veprimit dhe presionit sindikal

Për realizimin e qëllimeve të veta BSPK përdor të gjitha format ligjore të veprimit sindikal, si:

1. Dialogimin me partnerët socialë;
2. Hartimin, negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes kolektive në nivel vendi;
3. Informimin e drejtë dhe të vazhdueshëm për të gjithë të punësuarit;
4. Ndërmerr aktivitete adekuate solidare, në pajtim me programin dhe statutin e vet;
5. Protesta;
6. Greva;
 - a. Greva është mjeti i fundit i presionit sindikal dhe organizohet kur dështojnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e konfliktit me mjete të tjera ligjore;
 - b. I gjithë organizimi dhe rrjedha e grevës bëhet sipas Ligjit për grevat i Republikës së Kosovës.
 - c. Në të gjitha rastet duhet të jepet pëlqimi nga organi përkatës dhe të njoftohet kryesia e BSPK-së, gjegjësisht Këshilli Drejtues i BSPK-së, përveç në rast të ndonjë greve në federata sindikale të cilat marrin vendime brenda organeve të veta;
 - d. Vendimin për hedhje në grevë në nivel vendi e merr Këshilli Drejtues me shumicë votash, nëse për këtë paraprakisht kanë dhënë pëlqimin 2/3 e federatës anëtare të BSPK-së.

Neni 8

Informimi

1. BSPK informon anëtarësinë dhe opinionin rreth veprimtarisë së vet nëpërmjet mjeteve të informimit, të botimeve të veta, të tubimeve, të konferencave për shtyp, dhe nëpërmjet të përfaqësuesve të zgjedhur, të faqesueb, të broshurave dhe të formave të tjera të përshtatshme të informimit;
2. Nuk lejohet censurimi i informimit nga asnjë organ i BSPK-së;
3. Informimi duhet të jete objektiv, real dhe në interes të BSPK-së;
4. BSPK përmes Zyrës për Informim dhe organeve të saj, është e obliguar rregullisht ta informojë opinionin publik dhe anëtarësinë sindikaliste për punën dhe veprimtarinë e organeve të BSPK-së;
5. Federatat Sindikale kanë mundësi që informimin e anëtarësisë dhe të opinionit ta bëjnë nëpërmjet formave të informimit publik dhe nëpërmjet organeve të BSPK-së;
6. Për botimet e BSPK-së vendos Kryetari i BSPK-së;
7. BSPK mund të formojë zyra pune aty ku e sheh të arsyeshme dhe të nevojshme.

Neni 9

Anëtarësia

1. BSPK është organizim sindikal në nivel konfederate, që përfaqëson organizimet sindikale në nivel vendi;
2. Anëtarë të BSPK-së janë Federatat Sindikale, të cilat përfaqësojnë punëtorët në bazë të sektorit dhe profesionit të caktuar;
3. Një organizatë sindikale në nivel të federatës sindikale, mund të jetë anëtare e BSPK-së vetëm me përmbushjen e kriterëve të statutit të BSPK-së dhe që është e regjistruar në ministrinë përkatëse për regjistrim të organizatave sindikale si federatë sindikale;
4. Anëtarësimi në BSPK bëhet sipas vullnetit të lirë të federatave sindikale, duke respektuar vendimet e organeve përfaqësuese të tyre.

Neni 10

Kushtet e anëtarësimit në BSPK

Për tu anëtarësuar në BSPK, Federatat Sindikale duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Vendimin e organit më të lartë vendimmarrës;
2. Statutin e federatës sindikale, i cili duhet të jetë i harmonizuar me dispozitat e statutit të BSPK-së;
3. Numri i anëtarëve të federatës sindikale duhet të jetë së paku 500 (pesëqind) sipas deklaratave të plotësuar për anëtarësim dhe dëshmime të pagesës së kuotizacionit;
4. Pranimi i federatave sindikale në BSPK bëhet me përmbushjen e kriterëve nga paragrafët 1, 2, dhe 3 të këtij neni. Konstatimin për përmbushjen e këtyre kriterëve e bën Kryesia Ekzekutive, ndërsa vendimin e merr Këshilli Drejtues i BSPK-së;
5. Pala e pakënaqur mund të parashtojë ankesë pranë Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit;
6. Pala e pakënaqur me vendimin e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, mund të parashtojë ankesë pranë Këshillit Drejtues, si organ i shkallës së dytë, në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit.

Neni 11

Të drejtat dhe obligimet e Federatave të BSPK-së

1. Të drejtat e federatave sindikale anëtare të BSPK-së janë:
 - a. Të përfaqësohen në të gjitha organet e BSPK-së sipas kriterëve të parapara me këtë statut në bazë të numrit të anëtarësisë;
 - b. Të iniciojnë veprime sindikale sipas procedurave të parapara me statut;
 - c. Të mbrojnë autonominë e tyre në përputhje me dispozitat e këtij statuti;
 - d. Të drejtën e ndihmës profesionale nga BSPK;
2. Federatat Sindikale anëtare të BSPK-së kanë këto obligime:
 - a. Të paguajnë rregullisht kuotizacionin e anëtarësisë sindikale për BSPK në lartësi prej 1(një) Euro në vit për secilin të anëtarësuar;
 - b. Shlyerjen e të gjitha borxheve financiare ndaj BSPK-së duhet bërë deri më 31 mars të çdo viti, përveç nëse Kryetari i BSPK-së nxjerr vendim të veçantë për t'ua mundësuar pagesën në dy ose tri këste;
 - c. Të zbatojnë vendimet e organeve të BSPK-së;
 - d. Në rast të paraqitjes së nevojës, Këshilli Drejtues i BSPK-së ka të drejtë të caktojë ndonjë kuotizacion shtesë për tu paguar nga Federatat Sindikale anëtare të BSPK-së me kusht që votimi të jetë unanim.

Neni 12

Largimi i Federatave/Sindikatave nga BSPK

1. Federatat Sindikale humbin statusin e anëtarit të BSPK-së për këto arsye:
 - a. Në rast të shkeljes së parimeve themelore të këtij statuti;
 - b. Në rast të anëtarësimit të dyfishtë edhe në ndonjë konfederatë tjetër në nivel vendi;
2. Për mospagesën e kuotizacionit të anëtarësisë ashtu siç e parasheh neni 11, paragrafi b;
3. Detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e këtij statuti nuk do të pushojnë derisa të përfundojë procedura sipas nenit 11, paragrafi 2, pikat b, c dhe d;
4. Propozimin për heqjen e së drejtës së anëtarit të BSPK-së e jep Kryesia Ekzekutive, ndërsa vendimin e merr Këshilli Drejtues i BSPK-së, përveç rastit të mospagesës së kuotizacionit të anëtarësisë që me automatizëm e humb të drejtën e të qenët anëtare e BSPK-së.

Neni 13

Organizimi regjional i BSPK-së

1. Këshilli Drejtues formon zyrat regjionale varësisht me nevojat, mundësitë dhe interesat e anëtarësisë sindikale;
2. Puna e zyrave regjionale do të rregullohet me akt të veçantë juridik, të cilin e nxjerr Këshilli Drejtues i BSPK-së;
3. Zyrat regjionale shtrihen në tërë territorin e Republikës së Kosovës;
4. Koordinatori i zyrave regjionale emërohet nga Kryetari i BSPK-së, me propozimin paraprak nga Federatat Sindikale të regjionit përkatës;
5. Shkarkimi i koordinatorit të zyrave regjionale bëhet nga Kryetari i BSPK-së.

Neni 14

Rrjeti i Gruas i BSPK-së

1. Rrjeti Gruas i BSPK-së është strukturë organizative e BSPK-së;
2. Rrjeti i Gruas është bartës i projekteve me rëndësi të veçantë gjinore dhe përbëhet nga delegatet të cilat përfaqësojnë anëtarët e federatave/sindikatave;
3. Zgjedhja e delegateve dhe funksioni i Rrjetit të Gruas bëhet sipas mënyrës së përcaktuar me rregulloren e punës së Rrjetit të Gruas;
4. Kriteret për përfaqësim në Kuvendin e Rrjetit të Gruas i cakton Këshilli Drejtues i BSPK-së në bazë të numrit të anëtarëve të federatës;
5. Kryetarja e Rrjetit të Gruas, në bazë të funksionit është anëtare me të drejta të plota në Kongres, në Këshillin Drejtues me dy përfaqësuese dhe në Kryesinë Ekzekutive të BSPK-së;
6. Me qëllim të realizimit të objektivave të veta dhe funksionimit të tij, Rrjeti i Gruas do të gëzojë mjete financiare, e cila gjë do të rregullohet me aktin juridik për menaxhimin e financave të BSPK-së.

Neni 15

Rrjeti i të Rinjve i BSPK-së

1. Rrjeti i të Rinjve është strukturë organizative e BSPK-së;
2. Rrjeti i të Rinjve i BSPK-së është kompetent për përfaqësimin e anëtarëve të moshës rinore të BSPK-së, deri në moshën 35 vjeç;
3. Rrjeti i të rinjve është bartës i projekteve me rëndësi të veçantë për të rinjtë, me qëllim të promovimit të rinisë në shoqëri;
4. Rrjeti i të Rinjve përbëhet nga delegatët të cilët përfaqësojnë anëtarët e federatave sindikale;

5. Kriteret për përfaqësim në Kuvendin e Rrjetit të të Rinjve i cakton Këshilli Drejtues i BSPK-së në bazë të numrit të anëtarëve të federatës;
6. Zgjedhja e delegateve dhe funksioni i Rrjetit të të Rinjve bëhet sipas mënyrës së përcaktuar me Rregulloren e Punës së Rrjetit të të Rinjve;
7. Kryetari/ja e Rrjetit të të Rinjve, në bazë të funksionit është anëtar/e me të drejta të plota në Kongres, në Këshillin Drejtues me një përfaqësues dhe në Kryesinë Ekzekutive të BSPK-së;
8. Nga niveli i bazës e deri në piramidë, 30% e të zgjedhurve duhen të jenë të gjinisë femërore;
9. Me qëllim të realizimit të objektivave të veta dhe të funksionimit të tij, Rrjeti i të Rinjve do të gëzojë mjete financiare, e cila gjë do të rregullohet me aktin juridik për menaxhimin e financave të BSPK-së.

Neni 16 **Organet e BSPK-së**

1. Organet e BSPK-së janë:
 - a. Kongresi i BSPK-së;
 - b. Kryetari i BSPK-së;
 - c. Këshilli Drejtues i BSPK-së;
 - d. Kryesia Ekzekutive e BSPK-së;
 - e. Komisioni Mbikëqyrës i BSPK-së;
 - f. Komisioni Statutar i BSPK-së.
2. Organet e BSPK-së zgjidhen në mënyrë demokratike nga poshtë lart, japin llogari para zgjedhësve të tyre dhe janë të revokueshme nga ata.

Neni 17 **Kongresi i BSPK-së**

1. Kongresi është organi më i lartë i BSPK-së;
2. Kongresi i rregullt mbledhet një herë në 5 (pesë) vjet;
3. Vendimin për thirrjen e Kongresit e merr Këshilli Drejtues me shumicë votash, së paku dy muaj para mbajtjes së tij. Kongresi në kushte të jashtëzakonshme mund të mbahet edhe online.
4. Kongresi zhvillon punimet nëse janë të pranishëm 2/3 nga numri i përgjithshëm i delegatëve;
5. Statusin e delegatit në Kongresin e BSPK-së sipas funksionit e kanë anëtarët e Kryesisë Ekzekutive të BSPK-së, Koordinatorët e Zyrave Regjionale të BSPK-së, Kryetari i Komisionit Statutar, Kryetari i Komisionit Mbikëqyrës, Kryetarja e Rrjetit të Gruas dhe Kryetari/ja i/e Rrjetit të të Rinjve;
6. Statusin e delegatit në Kongresin e BSPK-së e kanë përfaqësuesit e Federatave Sindikale, të zgjedhur në organin vendimmarrës përkatës të tyre, sipas çelësit si në vijim: në çdo 300 (treqind) anëtarë plus një delegat;
7. Federatat Sindikale të cilat kanë mbi 25.000 (njëzetepesëmijë) anëtarë nuk mund të kenë më shumë se 49% të përfaqësuesve të përgjithshëm.
8. Mandati i delegatit është pesë vjeçar;
9. Së paku çdo i treti delegat duhet të jetë i gjinisë femërore;
10. Kongresi i jashtëzakonshëm, nëse është e nevojshme, mund të mbahet më parë, me kërkesën e 1/3 të delegatëve të Kongresit, me vendim të Këshillit Drejtues, me vendim të Kryesisë ose të Kryetarit të BSPK-së;
11. Vendimet në Kongres merren me shumicë të thjeshtë votash nga delegatët e pranishëm, ndërsa për formën e votimit vendoset në Kongres;

12. Para çdo votimi, Kryesia e Punës së Kongresit duhet të konstatojë kuorumin, ku për vendimmarrje nevojiten 50%+1 e delegatëve të pranishëm, nga numri i përgjithshëm i delegatëve të Kongresit, sipas paragrafit 4 të këtij neni;
13. Kryesinë e Punës së Kongresit Zgjedhor, në fazën e zgjedhjeve, nuk mund ta udhëheqë ai që është kandidat për t'u zgjedhur në ndonjë post në organet e BSPK-së.

Neni 18

Detyrat e Kongresit të BSPK-së

Detyrat e Kongresit janë:

1. Përcaktimi i drejtimeve kryesore të politikës sindikale dhe të programit të BSPK-së për periudhën e ardhshme 5 (pesë) vjeçare;
2. Miratimi i rezolutave për çështje të veçanta të lëvizjes sindikale;
3. Miratimi i Statutit të BSPK-së, me ndryshimet dhe plotësimet e tij;
4. Miratimi i Rregullores së Punës së Kongresit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të trupave punuese të BSPK-së, në mes të dy Kongreseve;
6. Zgjedhja dhe shkarkimi i Kryetarit të BSPK-së me 50%+1 të votave të delegatëve të pranishëm;
7. Zgjedhja dhe shkarkimi i anëtarëve të Komisionit Mbikëqyrës dhe të anëtarëve të Komisionit Statusor me 50%+1 të votave të delegatëve prezentë, me një konkurrencë të mbi 5 kandidatëve, 5 më të votuarit do të jenë pjesë e komisioneve ndërsa të tjerët mbesin rezervë për ndërrime eventuale;
8. Miratimi i raportit të punës dhe atij financiar të BSPK-së në mes dy Kongreseve;
9. Diskutimi dhe miratimi i raportit të Komisionit Mbikëqyrës;
10. Shqyrtimi i ankesave dhe parashtrësive që u janë drejtuar Kongresit;
11. Mund të ndryshojë/anulojë ndonjë akt normativ ose vendim të organeve të BSPK-së;
12. Zgjedhja e kryesisë së punës së Kongresit;
13. Zgjedhja e komisioneve verifikuese të Kongresit;
14. Zgjedhja e komisionit kandidues të Kongresit;
15. Zgjedhja e komisionit zgjedhor të Kongresit;
16. Zgjedhja edhe e komisioneve të tjera të nevojshme për punën e Kongresit;
17. Verifikimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues sipas propozimit të federatave sindikale;
18. Kongresi për funksionimin më efikas të BSPK-së mund të transferojë te Këshilli Drejtues i BSPK-së disa kompetenca brenda fushëveprimit të Kongresit;
19. U jep mirënjohje anëtarëve të BSPK-së.

Neni 19

Kongresi i Jashtëzakonshëm

Të drejtën për thirrjen e Kongresit të Jashtëzakonshëm e kanë:

1. Kryetari i BSPK-së;
2. Këshilli Drejtues mund të vendosë për thirrjen e Kongresit të Jashtëzakonshëm me kërkesën dhe nënshkrimin e 2/3 nga numri i përgjithshëm i anëtarëve;
3. Këshilli Drejtues duhet të përgatisë dokumentet e nevojshme për mbajtjen e Kongresit të Jashtëzakonshëm;
4. Kongresi i Jashtëzakonshëm thirret së paku një muaj para mbajtjes së tij.

Neni 20

Mbledhjet konstitutive të të gjitha organeve të BSPK-së

1. Brenda periudhës 45 ditëshe nga dita e mbajtjes së Kongresit duhen të mbahen të gjitha mbledhjet konstitutive të të gjitha organeve të BSPK-së;
2. Të gjithë kandidatët për pozitat në organet e BSPK-së duhen të jenë jopartiakë;
3. Të gjithë kandidatët për pozita në organet e BSPK-së duhen të kenë përgatitje profesionale universitare, përvojë të dëshmuar, punë në aktivitete sindikale dhe pëlqimin (letër rekomandimin) nga organet udhëheqëse të sindikatave prej nga vijnë.

Neni 21

Kryetari i BSPK-së

1. Kryetari është organi i BSPK-së, i cili paraqet unitetin dhe bashkëveprimin institucional të anëtarëve të BSPK-së;
2. Kryetari i BSPK-së zgjidhet me shumicën (50%+1) e delegatëve të pranishëm të Kongresit të BSPK-së;
3. Kryetari i BSPK-së mund të shkarkohet nga funksioni, nga delegatët e Kongresit të BSPK-së edhe para skadimit të mandatit, në rastet e shkeljes së dispozitave të këtij statuti, nëse nuk arrin të marrë vetëbesimin e 50% +1 të delegatëve të pranishëm;
4. Kryetari është funksionari më i lartë në BSPK dhe udhëheq me punën e Kryesisë Ekzekutive të BSPK-së;
5. Mandati i Kryetarit të BSPK-së është 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë rizgjedhje;
6. Kandidati për Kryetar të BSPK-së duhet të ketë mbështetjen e federatës/sindikatës reprezentuese, si dhe mbështetjen e një (1) Federate sindikale anëtare të BSPK-së;
7. Kandidati që paraqet kandidaturën për Kryetar të BSPK-së nuk mund të kandidojë në funksione të tjera udhëheqëse të BSPK-së;
8. Kandidati për Kryetar të BSPK-së krahas kandidimit duhet të paraqesë vizionin dhe programin e tij për BSPK-në në periudhën e ardhshme pesë vjeçare;
9. Në rast të vdekjes, të pamundësisë së ushtrimit të postit ose në rrethana të jashtëzakonshme Kryetarin e BSPK-së do ta zëvendësojë njëri nga Nënkryetarët e BSPK-së, në pajtim me nenin 22, paragrafi 4 i këtij Statuti.

Neni 22

Detyrat e Kryetarit të BSPK-së

1. Përfaqëson dhe vepron në emër të BSPK-së brenda dhe jashtë vendit;
2. Thërret dhe i udhëheq mbledhjet e Kryesisë Ekzekutive, si dhe mbledhjet e Kongresit të BSPK-së deri në zgjedhjen e Kryesisë së Punës;
3. Për punën nga kompetenca e tij i përgjigjet Kongresit;
4. Vendos për numrin e Nënkryetarëve që do të ketë BSPK-ja;
5. Propozon zgjedhjen dhe shkarkimin e Nënkryetarit/ve të BSPK-së, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje;
6. Së paku njëri nga Nënkryetarët (nëse janë dy) duhet të jetë i gjinisë femërore nëse Kryetari është i gjinisë mashkullore;
7. Koordinon punën e organeve të BSPK-së që bien nën kompetencën e tij;
8. Informon opinionin publik për veprimtarinë e BSPK-së;
9. Nënshkruan akte të ndryshme juridike në emër të BSPK-së;
10. Nënshkruan transaksione financiare në pajtim me linjat buxhetore të BSPK-së;
11. Merr vendime për çështjet urgjente të cilat nuk presin dhe për të njëjtat informon Kryesinë Ekzekutive në mbledhjen e radhës;

12. Udhëheq bashkëpunimin sindikal ndërkombëtar;
13. Është përgjegjës i fondeve në llogaritë e BSPK-së;
14. Kujdeset për zbatimin e detyrave që dalin nga organet e BSPK-së;
15. Angazhon Këshilltarë Profesionalë për nevoja të tij dhe të BSPK-së;
16. Emëron komisione të ndryshme për punën në BSPK dhe për përfaqësim në Këshillin Ekonomiko Social;
17. Propozon anëtarët e Këshillit Ekonomiko Social nga BSPK-ja;
18. Informon Kryesinë Ekzekutive lidhur me vizitat dhe përfaqësimet e BSPK-së brenda dhe jashtë vendit,
19. Zbaton vendimet e organeve të BSPK-së nga kompetenca e tij;
20. Lidh kontrata nga marrëdhënia e punës me të punësuarit në shërbimin profesional të BSPK-së në bazë të autorizimit personal;
21. Cakton personat përgjegjës për mbikëqyrje të zbatimit të kontratave të lidhura nga BSPK-ja;
22. Kryen punë ditore me interes për BSPK-në;
23. Kryen punë të tjera për të cilat ngarkohet nga Kongresi i BSPK-së;
24. I raporton Kryesisë Ekzekutive dhe Këshillit Drejtues dhe i përgjigjet Kongresit të BSPK-së;
25. Cakton personin përgjegjës për informim.

Neni 23

Nënkryetarët e BSPK-së

1. Nënkryetarët e BSPK-së, me propozimin e Kryetarit të BSPK-së, zgjidhen dhe shkarkohen nga Këshilli Drejtues;
2. Nënkryetarët e BSPK-së zgjidhen për një periudhë pesë (5) vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje;
3. Se paku njëri nga Nënkryetarët duhet të jetë i gjinisë femërore, nëse janë dy Nënkryetarë;
4. Nënkryetarët mund të shkarkohen edhe para skadimit të mandatit;
5. Kandidatët për Nënkryetarë të BSPK-së, preferohet të kenë mbështetjen e federatës së tyre sindikale reprezentative;
6. I ndihmojnë Kryetarit të BSPK-së në punët e përditshme dhe në detyrat që ai i angazhon;
7. Për punën e vet i raportojnë Kryetarit të BSPK-së dhe Kryesisë Ekzekutive.

Neni 24

Këshilli Drejtues i BSPK-së

1. Këshilli Drejtues i BSPK-së është organi më i lartë në mes të dy Kongreseve;
2. Këshilli Drejtues thirret së paku dy herë në vit;
3. Këshilli Drejtues i BSPK-së udhëhiqet nga kryetari i BSPK-së deri në kongresin e radhës.
4. Këshillin Drejtues e përbëjnë:
 - a. Kryetari dhe Nënkryetarët e BSPK-së;
 - b. Kryetarët e Federatave Sindikale anëtare të BSPK;
 - c. Kryetarja e Rrjetit të Gruas dhe dy përfaqësuese;
 - d. Kryetari/ja i/e Rrjetit të Rinjve të BSPK-së dhe një përfaqësues;
 - e. Koordinatorët e Zyrave Regjionale të BSPK-së;
 - f. Në çdo 1000 (një mijë) anëtarë, Federatat Sindikale përfaqësohen edhe me nga një anëtar, me ç'rast së paku çdo i treti përfaqësues i zgjedhur duhet të jetë femër;
5. Këshilli Drejtues i BSPK-së në mbledhjen e vet konstituive zgjedh Kryetarin dhe Nënkryetarët e Këshillit Drejtues;

6. Të propozuarit për Kryetar, Nënkryetar të Këshillit Drejtues duhen të kenë përgatitje profesionale universitare dhe përvojë të dëshmuar, punë në aktivitete sindikale në sindikatat prej nga propozohen;
7. Këshilli Drejtues mund të thirret edhe me kërkesën e 1/3 të anëtarëve të Këshilli Drejtues ose me kërkesën e Komisionit Mbikëqyrës;
8. Këshilli Drejtues ka kuorum nëse janë prezent 50%+1 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve;
9. Këshilli Drejtues merr vendime me votimin e shumicës së anëtarëve të pranishëm;
10. Këshilli Drejtues ka kompetencën e menaxhimit dhe të planifikimit të mjeteve financiare, si dhe të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të BSPK-së;
11. Këshilli Drejtues thirret me kërkesën e Kryetarit të BSPK-së në konsultim me Kryetarin e Këshillit Drejtues;
12. Deri në zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Drejtues mbledhjen e drejton Kryetari i BSPK-së;
13. Këshilli Drejtues i BSPK-së zgjedh Nënkryetarin/ët e BSPK-së të propozuar nga Kryetari i BSPK-së.

Neni 25

Kryetari i Këshillit Drejtues të BSPK-së

Kryetari i Këshillit Drejtues të BSPK-së ka këto kompetenca dhe detyrime:

1. Thërret mbledhjet e rregullta të Këshillit Drejtues në konsultim me Kryetarin e BSPK-së, në pajtim me dispozitat e këtij Statuti;
2. Udhëheq mbledhjet e Këshillit Drejtues dhe kujdeset për mbarrëvajtjen e tyre;
3. Thërret mbledhjet e jashtëzakonshme të Këshillit Drejtues, në të gjitha rastet kur përmbushen kushtet e parapara me nenin 23 të Statutit të BSPK-së;
4. Kujdeset për zbatim të drejtë të Rregullores së Punës së Këshillit Drejtues të BSPK-së;
5. Puna e Kryetarit të Këshillit Drejtues është punë vullnetare pa pagesë.

Neni 26

Kompetencat e Këshillit Drejtues të BSPK-së

1. Zbaton vendimet e Kongresit;
2. Organizon dhe drejton veprimtarinë sindikale të BSPK-së;
3. Në rastet kur pozita e Kryetarit të BSPK-së për arsye të ndryshme mbetet vakante;
4. Këshilli Drejtues me votimin e 2/3 nga numri i delegatëve të pranishëm, mundet që njërin Nënkryetar ta emërojë si ushtrues të detyrës së Kryetarit të BSPK-së deri në Kongresin e radhës, më së largu për një periudhë kohore prej 3 muajsh;
5. Miraton buxhetin vjetor të BSPK-së konform kërkesave për vitin e ri kalendarik;
6. Shqyrton dhe miraton Planin dhe Raportin e Punës të BSPK-së;
7. Shqyrton dhe miraton Raportin Financiar të BSPK-së;
8. Vendos për thirrjen e Kongresit dhe kryen punët përgatitore;
9. Vendos dhe shpall zgjedhjet në të gjitha strukturat dhe nivelet e BSPK-së;
10. Zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të BSPK-së;
11. Zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Komisionit Disiplinor të BSPK-së;
12. Shqyrton dhe miraton raportet e punës së organeve të cilat i zgjedh ose i legjitimon;
13. Vendos rreth nënshkrimit të Marrëveshjeve Sociale, të Marrëveshjes Kolektive dhe të Deklaratave në përputhshmëri me aktet ligjore;
14. Vlerëson, shqyrton dhe merr qëndrim lidhur me vendimet e Kryesisë së BSPK-së;
15. Verifikon propozimin e Kryesisë për Komisionin Mbikëqyrës dhe Komisionin Statutar;

16. Propozon kandidatët për organet punuese të Kongresit;
17. I informon Federatat Sindikale në lidhje me vendimet dhe me veprimet e Këshillit Drejtues;
18. Merr masa (rregullisht dhe tërësisht) për anëtarësimin e Federatave Sindikale në BSPK, për pagesën e kuotizacionit sindikal, si dhe për sigurimin dhe mbarëvajtjen e fondeve;
19. Organizon veprime të përbashkëta të solidaritetit që adresojnë çështjet sociale të punonjësve;
20. Organizon forma të ndryshme të veprimit sindikal për të drejtat e anëtarëve të konfederatës të garantuara me marrëveshjen kolektive, me kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare;
21. Vendos në shkallë të dytë sipas procedurës me ankesë për pranimin dhe largimin sindikatave të pavarura në BSPK;
22. Miraton edhe merr vendime të tjera në interes për BSPK-në;
23. Vendos për grevën si formë e presionit sindikal;
24. Miraton Rregulloren e Punës së Këshillit Drejtues.

Neni 27

Këshilli Drejtues i Jashtëzakonshëm

1. Këshilli Drejtues i Jashtëzakonshëm thirret me kërkesën e Kryetarit të BSPK-së;
2. Këshilli Drejtues i Jashtëzakonshëm thirret me kërkesën e 2/3 të anëtarëve të Kryesisë Ekzekutive të BSPK-së;
3. Këshilli Drejtues i Jashtëzakonshëm thirret me kërkesën e 1/3 të anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Neni 28

Kryesia Ekzekutive e BSPK-së

1. Kryesia e BSPK-së është organ ekzekutiv i BSPK-së;
2. Anëtarë të Kryesisë së BSPK-së janë:
 - a. Kryetari i BSPK-së;
 - b. Nënkryetari/ët e BSPK-së;
 - c. Kryetarët e Federatave Sindikale anëtare të BSPK-së;
 - d. Kryetari i Këshillit Drejtues,
 - e. Kryetarja e Rrjetit të Gruas së BSPK-së;
 - f. Kryetari/ja e Rrjetit të Rinjve të BSPK-së;
 - g. Federatat Sindikale që kanë numër më të madh të anëtarëve përfaqësohen në Kryesinë Ekzekutive edhe me anëtarë të tjerë në këtë mënyrë: Në çdo 5000 anëtarë edhe një anëtar shtesë në Kryesinë Ekzekutive;
 - h. Anëtarët shtesë në Kryesinë Ekzekutive nga Federata duhen të jenë të gjinisë femërore;
3. Mbledhjet e Kryesisë Ekzekutive mbahen sipas nevojës së paraqitur në BSPK, por të paktën një herë në muaj;
4. Mbledhja e Kryesisë Ekzekutive thirret me iniciativën e Kryetarit të BSPK-së, ose me kërkesën e 1/3 të anëtarëve të saj, në afatin prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës;
5. Mbledhjet e Kryesisë Ekzekutive i udhëheq Kryetari i BSPK-së;
6. Mbledhja e Kryesisë Ekzekutive mund të mbahet edhe online.

Neni 29

Detyrat e Kryesisë Ekzekutive të BSPK-së

1. Zbaton vendimet e Këshillit Drejtues të BSPK-së;
2. Monitoron dhe vlerëson zbatimin e marrëveshjeve shoqërore, të Marrëveshjes Kolektive, ligjeve dhe akteve të tjera ligjore;
3. Miraton rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në BSPK të propozuara nga Kryetari i BSPK-së;
4. Emëron dhe shkarkon grupe punuese për të negociuar dhe lidhur marrëveshje kolektive dhe ua jep atyre udhëzimet e duhura për negociatat;
5. Shqyrton dhe merr vendime lidhur me iniciativat dhe propozimet e federatave / sindikatave;
6. Emëron përfaqësuesit e BSPK-së në organe dhe në organizata të tjera;
7. Jep opinionin rreth ligjeve, rregulloreve dhe dokumenteve të tjera;
8. Përcjell ecurinë e buxhetit dhe zbatimin e planit ekonomik dhe financiar;
9. Vendors për transaksione financiare në pajtim me linjat buxhetore të BSPK-së;
10. Harton planin financiar për periudhën vijuese;
11. Vendors për krijimin e fondeve të caktuara;
12. Koordinon veprimet sindikale në të gjitha nivelet e organizimit sindikal;
13. Sipas nevojës formon trupa punuese;
14. Për punën e vet Kryesia Ekzekutive i përgjigjet dhe i raporton Këshillit Drejtues;
15. Nxjerr vendime me interes për BSPK-në;
16. Merr vendim për angazhimin e ndonjë eksperti nga fusha e caktuar;
17. Mbikëqyr Shërbimin Profesional të BSPK-së;
18. Vendors për publikimet e BSPK-së;
19. Sipas nevojës formon trupa punuese;
20. Miraton Rregulloren e Punës së Kryesisë Ekzekutive të BSPK-së;
21. Kryen edhe punë të tjera të cilat ia delegon Këshilli Drejtues.

Neni 30

Në rast se në Komisionin Mbikëqyrës ose Statutor të BSPK-së largohet ndonjë prej anëtarëve të komisionit, për çfarëdo arsye, Kryetari i BSPK-së kujdeset për funksionimin e komisioneve, të cilat me vendim të veçantë i plotëson me anëtar të ri.

Komisioni Mbikëqyrës i BSPK-së

1. Komisioni Mbikëqyrës i BSPK-së përbëhet prej pesë (5) anëtarëve;
2. Kryetari i Komisionit duhet të jetë me përgatitje adekuate profesionale, nga lëmi përkatës dhe së paku dy nga anëtarët duhet të jenë të gjinisë femërore;
3. Anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës zgjidhen me vota të fshehta, më së paku nga një kundërkandidat dhe ata që mbesin me vota më pak mbesin në listën rezervë;
4. Komisioni zgjedh Kryetarin nga radhët e anëtarëve të tij;
5. Komisioni i zhvillon mbledhjet nëse janë të pranishëm shumica e anëtarëve;
6. Komisioni është i obliguar që të mbledhet të paktën një herë në vit për të kontrolluar të hyrat dhe të dalat e mjeteve financiare në BSPK;
7. Anëtar i Komisionit i cili mungon në mbledhje pa arsye të justifikueshme me propozimin e Kryetarit të Komisionit mund të zëvendësohet nga Kryetari i BSPK-së me anëtarin nga lista rezervë.

Neni 31

Detyrat e Komisionit Mbikëqyrës të BSPK

1. Komisioni përcjell zbatimin e politikave të përcaktuara financiare në BSPK;
2. Bën kontrollimin e dokumentacionit financiar të BSPK-së;
3. Kontrollon librat e kontabilitetit të BSPK-së së paku një herë në vit ose me kërkesë të Kryesisë së BSPK-së edhe më shumë se një herë në vit;
4. Komisioni vepron në mënyrë te pavarur;
5. Shërbimi Profesional i BSPK-së është i obliguar t'ia prezantojë dokumentacionin e kërkuar Komisionit në formën në të cilën e kërkon ai;
6. Komisioni jep sugjerime për çështje të caktuara në përputhje me rregullat e kontabilitetit dhe ligjet në fuqi;
7. Për punën e vet i raporton Këshillit Drejtues në formë të shkruar, të paktën një herë në vit;
8. Komisioni vendos me shumicën e votave dhe punon në bazë të rregullores së punës;
9. Komisioni Mbikëqyrës bën pranim-dorëzimin e mandatit të Kryetarit dhe të dokumentacionit të plotë të BSPK-së, më së largu tri ditë nga zgjedhja e kryetarit të ri të BSPK-së, për këtë edhe mban procesverbal.

Neni 32

Komisioni Statutar i BSPK-së

1. Komisioni Statutar përbëhet prej pesë (5) anëtarëve;
2. Kryetari i Komisionit Statutar duhet ta ketë përgatitjen adekuate profesionale, nga fusha përkatëse dhe së paku njëri nga anëtarët duhet të jetë femër;
3. Anëtarët e Komisionit Statutar zgjidhen me vota të fshehta më së paku nga një kundërkandidat dhe ata që mbesin me vota më pak mbesin në listën rezervë;
4. Anëtarët e Komisionit Statutar zgjidhen për një mandat prej 5 vjetësh;
5. Komisioni zgjedh Kryetarin e Komisionit Statutar nga radhët e anëtarëve të vet;
6. Komisioni i zhvillon mbledhjet nëse janë të pranishëm shumica e anëtarëve;
7. Mbledhjet e Komisionit mbahen sipas nevojës së paraqitur;
8. Anëtari i Komisionit i cili mungon në mbledhje pa arsye të justifikueshme, me propozimin e Kryetarit të komisionit mund të zëvendësohet nga Kryetari i BSPK-së me anëtarin nga lista rezervë.

Neni 33

Detyrat e Komisionit Statutar

1. Mbikëqyr harmonizimin e dispozitave të statuteve të federatave/sindikatave me dispozitat e statutit të BSPK-së;
2. Siguron spastrimin e tekstit të statutit me vërejtje dhe ndryshime, të miratuar në Kongres;
3. Gjatë punës së tij, Komisioni, mund të kërkojë nga Federatat Sindikale ose nga organet e tjera të BSPK-së që për çështje të caktuara të kthejnë përgjigje brenda 8 ditësh;
4. Komisioni vepron sipas kërkesës së Këshillit Drejtues, të Kryesisë Ekzekutive dhe të Kryetarit të BSPK-së;
5. Komisioni Statutar merr vendime në mbledhjen e tij brenda 30 ditëve nga marrja e ankesës në procedurë të rregullt;
6. Komisioni miraton rregulloren e punës;
7. Dokumentet që nxjerr Komisioni Statutar janë konkluzionet dhe vendimet;
8. Dokumentet janë përfundimtare dhe të detyrueshme në qoftë se për to nuk parashtrohet ankesë brenda afatit të parashikuar;
9. Komisioni për punën e tij i përgjigjet Këshillit Drejtues;
10. Komisioni vendos me shumicën e votave dhe punon në bazë të rregullores së punës;
11. Anëtarët e Komisionit nuk mund të jenë në të njëjtën kohë pjesë e Këshillit Drejtues, e Kryesisë Ekzekutive ose e çfarëdo organi tjetër të BSPK-së.

Neni 34

Trupat organizative të BSPK-së

Trupat organizative të BSPK-së janë:

1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve;
2. Komisioni Disiplinor.

Neni 35

Komisioni i Zgjidhjeve të Kontesteve dhe Ankesave

1. Komisioni i Zgjidhjeve të Kontesteve dhe Ankesave përbëhet prej 3 (tre) anëtarëve, njëri prej të cilëve duhet të jetë jurist, duhet të ketë përfaqësim gjinor dhe etnik nëse është e nevojshme;
2. Mandati i Komisionit të Zgjidhjeve të Kontesteve dhe Ankesave është dy vjet me të drejtë rizgjedhje edhe për dy vjet;
3. Komisioni zgjedh Kryetarin e vet, nga radhët e anëtarëve të vet,
4. Komisioni mund t'i zhvillojë mbledhjet e veta nëse janë të pranishëm shumica e anëtarëve;
5. Mbledhjet e Komisionit mbahen sipas nevojës pas paraqitjes së ankesave;
6. Komisioni brenda 5 (pesë) ditësh duhet të njoftohet për ankesat nga dita e parashtrimit të tyre;
7. Të gjitha shërbimet administrative për Komisionin e Zgjidhjeve të Kontesteve dhe Ankesave duhet t'i bëjë Shërbimi Profesional i BSPK-së;
8. Pala e pakënaqur me vendimet e Komisionit të Zgjidhjeve të Kontesteve dhe Ankesave brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e vendimit ka të drejtë të ankohet në Këshillin Drejtues të BSPK-së.

Neni 36

Detyrat e Komisionit të Zgjidhjeve të Kontesteve dhe Ankesave

1. Zgjedh kontestet e natyrave të ndryshme duke u mbështetur në statutin e BSPK-së;
2. Vepron në bazë të parashtrimit të kërkesave nga palët e interesuara në kuadër të BSPK-së;
3. Palët e pakënaqura me konkludimet e Komisionit mund të kërkojnë fillimin e procedurës pranë Këshillit Drejtues i cili merr vendimin përfundimtar;
4. Gjatë punës së vet Komisioni mund të angazhojë ekspertë të lëmit përkatës me qëllim të zgjidhjes së drejtë të kontestit;
5. Organet e BSPK-së dhe të federatave/sindikave janë të obliguara që t'i japin ndihmë Komisionit në formën që ai kërkon;
6. Komisioni për punën e tij i përgjigjet Këshillit Drejtues;
7. Komisioni vendos me shumicën e votave dhe punon në bazë të rregullores së punës;
8. Komisioni brenda 30 ditësh, nga dita e parashtrimit të ankesës, duhet të sjellë vendimin për ankesën e shqyrtuar;
9. Anëtarët e Komisionit nuk mund të jenë në të njëjtën kohë pjesë e Këshillit Drejtues, e Kryesisë Ekzekutive ose e çfarëdo organi tjetër të BSPK-së.

Neni 37

Komisioni Disiplinor

1. Komisioni Disiplinor përbëhet prej 3 (tre) anëtarëve, të cilët zgjedhën nga Këshilli Drejtues, njëri prej të cilëve duhet të jetë jurist, duhet të ketë përfaqësim gjinor dhe etnik nëse është e nevojshme;
2. Mandati i Komisionit Disiplinor është dy vjet me të drejtë rizgjedhjeje edhe për pesë vjet;

3. Procedura disiplinore mund të zhvillohet edhe ndaj të punësuarit në shërbimin profesional të BSPK-së, në këto raste:
 - a. Nëse ka bërë shkelje të detyrave dhe përgjegjësi nga marrëdhënia e punës;
 - b. Në rast të sjelljeve të këqija në vendin e punës, mospërmbylljes së kënaqshme të punëve dhe të detyrave të punës, të mungesës pa arsye nga puna për tri ditë radhazi;
 - c. Sipas fletëparaqitjes së ushtruar nga ana e udhëheqësit të tij;
 - d. Në rastet e tjera të parapara në rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës të BSPK-së.

Neni 38

Detyrat e Komisionit Disiplinor

1. Komisioni duhet t'i zhvillojë mbledhjet e veta nëse janë të pranishëm shumica e anëtarëve, dhe vendimet duhet të merren në mënyrë unanime;
2. Komisioni zgjedh Kryetarin nga radhët e anëtarëve të vet;
3. Komisioni i zhvillon mbledhjet nëse janë të pranishëm të gjithë anëtarët e vet;
4. Komisioni vendos në shkallë të parë;
5. Kundër vendimit të Komisionit pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë pranë Kryesisë së BSPK-së brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e vendimit;
6. Mbledhjet e Komisionit mbahen sipas nevojës pas paraqitjes së rastit disiplinor për shqyrtim;
7. Komisioni Disiplinor duhet të sjellë vendimin për rastin e shqyrtuar brenda 30 ditësh nga dita e paraqitjes së rastit për shqyrtim;
8. Vendimet e Komisionit merren në mënyrë unanime;
9. Komisioni për punën e vet i përgjigjet Këshillit Drejtues;
10. Në mbledhjet e Komisionit Disiplinor merr pjesë edhe juristi i Shërbimit Profesional të BSPK-së, për tu siguruar rreth mbarëvajtjes së procedurave dhe për t'i asistuar lidhur me çështjet administrative.

Neni 39

Financimi i BSPK-së

1. BSPK financohet nga:
 - a. Kuotizacioni i anëtarësisë sindikale;
 - b. Donacionet;
 - c. Ndihmat;
 - d. Mjetet e fituara;
 - e. Mjetet e tjera që nuk janë në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Neni 40

Pasuria e BSPK-së

1. Pasurinë e BSPK-së e përbëjnë mjetet e grumbulluara nga kontributet e anëtarëve të saj, si dhe gjithë pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, të cilën e ka fituar, trashëguar ose blerë kudo që ndodhet ajo;
2. BSPK mund të formojë njësi ekonomike, të cilat menaxhohen nga organet e saj.

Neni 41
Kuota e anëtarësisë

1. Federatat, anëtarët e BSPK-së paguajnë kuotizacionin e anëtarësisë në BSPK, në pajtim me nenin 10, paragrafi 2 të këtij statuti;
2. Distribrimi proporcional i kuotizacionit bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë në konton përkatëse të BSPK-së;
3. Studentët që dëshirojnë të jenë anëtarë të sindikatës, duhet të paguajnë 1 € (një euro) në vit.

Neni 42
Shërbimi Profesional i BSPK-së

1. Shërbimi Profesional i BSPK-së duhet të kujdeset për kryerjen e punëve profesionale në interes dhe për nevoja të BSPK-së;
2. Shërbimi Profesional përbëhet nga këta sektorë:
 - a. Sektori Profesional – Ligjor;
 - b. Sektori Financiar – Ekonomik;
 - c. Sektori i Informimit dhe i Teknologjisë së Informacionit;
 - d. Sektori për Marrëdhënie me Jashtë;
 - e. Sektori Administrativ - Teknik.
3. Puna e Shërbimit Profesional përcaktohet me rregulloren për funksionimin e Shërbimit Profesional të BSPK-së të cilën e aprovon Këshilli Drejtues i BSPK-së ose Kryesia Ekzekutive sipas propozimit të Kryetarit të BSPK-së.

Neni 43
Ndërprerja e funksionit (mandatit) sipas fuqisë ligjore

Të zgjedhurve në organet e BSPK-së u përfundojnë funksionet e tyre në këto raste:

1. Me dorëheqje;
2. Me vdekjen e të zgjedhurit;
3. Me skadimin e mandatit 5 vjeçar;
4. Kur i zgjedhuri e mbush moshën e pensionimit prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç;
5. Në ditën e dorëzimit të aktvendimit të plotfuqishëm për vërtetimin e humbjes së aftësive për punë;
6. Nëse i punësuar shkon në vuajtje të dënimit, i cili do të zgjasë më tepër se gjashtë (6) muaj;
7. Në rastet e tjera të përcaktuara sipas dispozitave të këtij statuti dhe ligjeve në fuqi.

Neni 44
Dispozitat kalimtare

1. Statuti është akti më i lartë juridik i BSPK-së dhe hyn në fuqi pas miratimit të tij nga delegatët e Kongresit dhe nënshkrimit nga Kryetari i BSPK-së;
2. Sindikatat/Federatat obligohen që të bëjnë harmonizimin e Statutit të tyre me këtë Statut, në një periudhë kohore brenda 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij statuti.

Neni 45
Vlefshmëria e këtij Statuti

1. Me këtë statut rregullohet mënyra e organizimit dhe e fushëveprimit të organeve të BSPK-së;
2. Statutet e federatave/sindikatave nuk mund të jenë në kundërshtim me parimet themelore të statutit të BSPK-së;
3. Iniciativën për ndryshim ose për plotësim të Statutit mund ta iniciojë 1/3 e delegatëve të Kongresit, Kryetari i BSPK-së, Këshilli Drejtues dhe Kryesia e BSPK-së.

Neni 46
Sqarimi i dispozitave

1. Sqarimin e dispozitave të këtij Statuti e bën Komisioni Statutar dhe Kongresi i BSPK-së.

Neni 47
Shfuqizimi

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, shfuqizohet Statuti i BSPK-së i miratuar më 13 dhjetor 2025 e protokolluar më 04.02.2026 nën numrin 113, si dhe të gjitha aktet e tjera që janë në kundërshtim me dispozitat e këtij statuti
2. Aktet nënstatutare të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij Statuti mbeten në fuqi përkohësisht, për aq sa nuk bien ndesh me dispozitat e reja statutare.

Neni 48
Hyrja në fuqi

3. Ky Statut hyn në fuqi ditën e miratimit dhe të nënshkrimit nga Kryetari i BSPK-së.

Kryetari i BSPK-së

Prof. dr. Atdhe Hykolli

Në Prishtinë,

më 11 korrik 2026

